

VENDIM
Nr. 54, datë 29.3.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “IRARBA ENERGJI” SHPK PËR TRANSFERIMIN E
ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UNITED BANK OF
ALBANIA) SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neni 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 406/4 prot., datë 25.3.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a.”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1012 prot., datë 18.10.2021, shoqëria “Irarba Energji” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng të aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shoqërisë (United Bank of Albania sh.a.).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 21.1.2022, vendosi zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë pune të afatit të vendimarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e aseteve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a., duke filluar ky afat nga data 12.2.2022.

- Në vijim, shoqëria ka depozituar një aplikim për financim biznesi të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë protokolluar në ERE me nr. 194/1 prot., datë 8.2.2022, për një periudhë 7-vjeçare.

- Për sa depozituar nga shoqëria, ERE iu drejtua bankës me shkresën nr. 194/2 prot., datë 21.2.2022, duke i kërkuar që të informojë ERE-n nëse është nënshkruar kontrata përkatëse e kredisë, referuar aplikimit të shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për financim, e nëse kontrata është nënshkruar, depozitimin e saj në ERE, së bashku me listën përkatëse të aseteve që vendosen si mjete për garantimin e detyrimit që lind nga kjo kontratë. Nga Banka nuk ka pasur kthim përgjigjeje, ndaj ERE, për arsye të sigurisë së disponimit të shkresës, vlerësoi ridërgimin e shkresës, me e-mail në datën 25.3.2022.

- Duke qenë se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, në kuadër të këtij aplikimi, nuk është e qartë natyra e marrëveshjes/marrëveshjeve me bankën mbi këtë transferim dhe me qëllim rakordimin e listës së aseteve, duke e vlerësuar si një dokument thelbësor për vendimarrjen për dhënien e autorizimit për transferimin e këtyre aseteve, në mbështetje të nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe referuar përcaktimeve të nenit 10, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores së procedurave për transferimin e aseteve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, vlerësohet zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit për depozitimin e dokumentacionit/informacionit nga shoqëria ose banka, në lidhje me nënshkrimin e kontratës përkatëse të kredisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin për depozitimin e dokumentacionit/informacionit nga shoqëria “Irarba Energji” sh.p.k. ose Banka e Bashkuar e Shqipërisë (United Bank of Albania sh.a.) në lidhje me nënshkrimin e kontratës përkatëse të kredisë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti